



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE NDJEKJES SË INVESTIMEVE TË
INFRASTRUKTURËS

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2019

Lënda: Përgjigje kërkesë për informacion

e.mail: _____@gmailmail.com

Në vijim të kërkesës suaj, drejtuar Bashkisë Shkodër me anë të postës elektronike dhe regjistruar me nr.7042 prot, datë 30.04.2019, në të cilën bazuar në ligjin nr.119/2014, “Për të Drejten e Informimit” kërkonti informacion, mbi menaxhimin e përmbytjeve nga Bashkia Shkodër, ju bëjmë me dije se:

Zonat që rrezikohen nga përmbytjet në territorin e Bashkisë Shkodër janë: Njësia Administrative Gur Zi, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Velipojë, Rrethina dhe një pjesë e lagjeve të qytetit, të cilat janë në afërsi të lumenjve Drin dhe Bunë dhe të liqenit të Shkodrës.

Numrin e popullsisë të Bashkisë Shkodër, mund ta gjeni duke klikuar në http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/Mbi_organizimin_dhe_funksionimin_e_Bashkise_1091_1.php

Gjatë përmbytjeve të vitit 2018, janë vlerësuar dëme për 19 banesa në Njësinë Administrative Ana e Malit, 17 banesa në Dajç dhe 23 banesa në qytet dhe Njësinë Administrative Rrethina.

Aktivitet kryesore ekonomike kanë të bëjnë me serat, bimët dekorative, foraxhere, drithëra etj. Numrin e aktivitete ekonomike sipas njësive administrative mund ta gjeni në http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/7_raporti_i_vleresimeve_dhe_parashikimeve_afatmesme_te_te_ardhurave_2020_2022_2303.pdf

Në rastet e përmbytjeve Bashkia Shkodër krijon strukturat përkatëse për menaxhimin e situatave. Informacion më të detajuar mbi planin për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, mund të gjeni duke klikuar në faqen e internetit <http://qarkushkoder.gov.al/>, tek “Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike në Ballanin Perëndimor”.

Në vijimësi të planeve kundër përmbytjeve masat e para janë monitorimi dhe njoftimet e hershme të banorëve dhe strukturave duke vepruar menjëherë për mbrojtjen e banorëve. Kanë funksionuar skemat e lajmërimit dhe evakuimit, janë kryer masat e hartuara për mbajtjen nën kontroll të territorit me gjithë gjendjen në kushte emergjence, duke bërë të mundur kalimin e kësaj gjendjeje pa pasoja jetësore dhe të gjësë së gjallë.

Vendstrehimet për familjet në nevojë në rastet e evakuimeve, janë godinat e konvikteve të shkollave të mesme të qytetit dhe palestrat, si dhe vendet e përcaktuara për evakuimin e gjësë së gjallë në Bërdicë dhe pranë tregut të gjësë së gjallë në Golem.

Është ngritur Qendra Operacionale pranë Bashkisë Shkodër ku është punuar pa ndërprerje për 24 orë si edhe në terren, duke ruajtur komunikimin për marrje dhe dhënie informacioni të vazhdueshëm dhe në kohë reale nëpërmjet nr. telefonik të shpallur dhe në njoftimet zyrtare duke ndihmuar në zvogëlimin e pasojave të mundshme duke marrë pjesë në aktivizimin e strukturave përgjegjëse për mbrojtjen civile të Bashkisë dhe në qëndrimin sa më afër banorëve dhe kontributin direkt pranë tyre. Banorëve u është shërbyer me furnizime me ujë të pijshëm dhe pako ushqimore si dhe me bazë ushqimore për gjënë e gjallë si nevojat më të domosdoshme primare, të ardhura në formë ndihme apo donacione nga Institucione publike apo private të ndryshme.

Magazinat e rezerve shtetëtare më të afërta janë pranë F.N.SH, në qytetin Shkodër.

Për njoftimin e hershëm, komunikohet vazhdimisht me institucionet qendrore si Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe Qendrën Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile, me Institutin e Gjeoshkencave për parashikimin e motit, me Institucionin e Prefektit Shkodër dhe institucione të tjera si burime të besueshme informacioni dhe bëhet përcjellja në kohë e informacionit me mënyrat më të shpejta direkte publike.

Për informacion mund të klikoni dhe në http://drincorda.iwlearn.org/library-main/meetings/stakeholder-conferences/copy_of_material-from-the-4th-drin-stakeholders-conference/presentations/Session%202.3/felek-kasemi_5th-drin-stakeholders-conference-2017.

Me anë të e.mail, do ju dërgojmë dhe raportin “Për hartimin e P.P.V Shkodër” si dhe një përgjigje për një kërkesë për informacion, për përmbytjet e muajit mars 2018.

Duke shpresuar se, materiali i dërguar do të jetë i vlefshëm për punën tuaj kërkimore, me respekt

KRYETAR

Voltana ADEMI